



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Ligji Nr. 03/L-063

LIGJI PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të neneve 65(1) dhe 129 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke njohur se nevoja për informacion me kohë dhe të saktë për inteligjencë, kundërinteligjencë, kërcënime nga brenda dhe jashtë, terrorizmin ndërkombëtar apo vendor, prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, krimin e organizuar, krimin ekonomik, sabotazhin dhe të gjitha çështjet tjera të inteligjencës të lidhura me sigurinë e Kosovës është esenciale për popullin e Kosovës;

Duke njohur se të gjitha mjetet e arsyeshme dhe ligjshme duhet të përdoren për të siguruar që Kosova do të pranojë informatat më cilësore të inteligjencës që janë në dispozicion;

Për këtë qëllim, do të themelohet Agjencia e Kosovës për Inteligjencë për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë këto informata në mënyrë të shpejtë dhe përgjegjshme. Parimet e parashtruara në këtë ligj janë hartuar për të arritur një baraspeshë të duhur ndërmjet marrjes së informacionit esencial dhe mbrojtjes së interesave individuale,

Miraton këtë

LIGJIN PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITSHME

Neni 1

Themelimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

1.1 Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (në vijim AKI) themelohet si agjenci për siguri dhe inteligjencë në Kosovë.

1.2 AKI qeveriset në bazë të këtij ligji në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të gjitha ligjet tjera në fuqi në Kosovë.

1.3 AKI është person juridik.

1.4 AKI ka mandat të veprj në tërë territorin e Kosovës.

1.5 Ndalohet çdo përdorim i teknikave të fshehta në Kosovë pa autorizim të posaçëm në bazë të ligjit.

1.6 Mjetet financiare për veprimtarinë e AKI-së sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi për të.

1.7 Në varësi të nevojave specifike operative të AKI-së, AKI, po ashtu, mund të krijoj prani në terren brenda Kosovës për kryerjen e detyrave brenda mandatit të AKI-së.

Neni 2

Fusha e veprimit

2.1 AKI mbledhë informacion në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës. Në çdo rast kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës konsiderohet kërcënimi ndaj integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës, duke përfshirë:

- (i) terrorizmin;
- (ii) nxitjen, ndihmën dhe shtytjen ose përkrahjen e terrorizmit;
- (iii) spiunazhin kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë së Kosovës;
- (iv) sabotazhin drejtuar kundër infrastrukturës vitale të Kosovës;
- (v) krimin e organizuar kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë së Kosovës në cilëndo mënyrë, duke përfshirë larjen e parave;
- (vi) nxitjen e pakënaqësisë në strukturat e sigurisë;
- (vii) trafikimin e substancave ilegale, armëve apo qenieve njerëzore;
- (viii) prodhimin ilegal apo transportin e armëve të shkatërrimit në masë, ose të komponentëve të tyre, si dhe materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për prodhimin e tyre;
- (ix) trafikimin ilegal të prodhimeve dhe teknologjive nën Kontrollin Ndërkombëtar;
- (x) aktivitetet që bien ndesh me të drejtën humanitare ndërkombëtare;
- (xi) aktet e dhunës së organizuar apo të frikësimit kundër grupeve etnike apo fetare në Kosovë, dhe
- (xii) çështjet që kanë të bëjnë me kërcënime serioze ndaj shëndetit apo sigurisë publike.

2.2 Për të avancuar aktivitetet e AKI-së të paraqitura në Nenin 2.1 më lartë, dhe në pajtim me nenet 28 dhe 30 të këtij ligji, AKI ka mundësitë e veta për mbledhjen e informacionit, që përfshijnë:

- (i) përgjimin mobil dhe statik;
- (ii) personelin e fshehtë për mbledhjen e informacioneve;
- (iii) përgjimin teknik, siç janë pajisjet për dëgjim, përgjim dhe përcjellje;
- (iv) agjentët e fshehtë;
- (v) mbledhjen e të dhënave konfidenciale, si nga bankat, portet dhe telefonin.

2.3 Prioritetet strategjike të AKI-së parashtrihen në Platformën Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë (në vijim PVPIS), e cila përmban udhëzimet e përgjithshme për punën e AKI-së. Drejtori i AKI-së propozon një version të Platformës Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë Këshillit të Sigurisë të Kosovës (në vijim KSK) për shqyrtim nga ana e tyre. Pas konsultimit me Presidentin e Republikës së Kosovës, PVPIS i dorëzohet për miratim Qeverisë. Pas miratimit, PVPIS i dorëzohet Organit Mbikëqyrës Parlamentar për informim, dhe Drejtorit të AKI-së, për veprim.

2.4 AKI-ja nuk vepron kundër të drejtave dhe interesave të asnjë komuniteti e as diskriminon ndonjë person mbi çfarëdo baze siç është gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo ndonjë tjetër, prejardhja kombëtare apo shoqërore, lidhja me një pakicë kombëtare, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.

2.5 AKI-ja respekton parimet e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, dhe parimet tjera relevante të pasqyruara në instrumentet ligjore të njohura ndërkombëtarishtë dhe kryen aktivitetet e veta në pajtueshmëri me to.

Neni 3 **Funksionet e ndaluara të AKI-së**

3.1 AKI nuk ka funksione ekzekutive. Në këtë mënyrë, AKI nuk ka:

- (i) të drejtën të përdorë forcë direkte apo indirekte;
- (ii) çfarëdo autoriteti për arrest;
- (iii) mundësinë të iniciojë procedura penale, dhe
- (iv) autorizimin të detyrojë persona apo kompani të bashkëpunojnë për aktivitetet e saj, ndonëse persona apo kompani mund të bashkëpunojnë me AKI-në mbi baza vullnetare.

3.2 AKI nuk do të mbledhë informata duke përdorë mekanizma dhe metoda të fshehta në lidhje me palët e treta që gëzojnë imunitetet dhe privilegjet diplomatike, që janë në përputhje me Ligjin për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misionëve Diplommatike, Konsullore dhe Personelin e tyre në Republikën e Kosovën dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake dhe Personelin e saj, si dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplommatike, me përjashtim të

rasteve kur synohet parandalimi i kërcënimeve ndaj këtyre organizatave dhe organeve. Drejtori i AKI-së është i obliguar të informojë krerët e këtyre organizatave dhe organeve për të gjitha kërcënimet e tilla.

3.3 Të gjitha veprimet apo mosveprimet e AKI-se dhe të punonjësve të saj janë në pajtim me ligjin në fuqi, duke përfshirë instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të përshkruara mes tjerash në nenin 2.5 më lartë.

3.4 Qeveria e Kosovës mban përgjegjësi për dëmet e shkaktuara ndaj personave juridik apo fizik si rezultat i veprimeve të punonjësve të AKI-së të ndërmarrura gjatë kryerjes së detyrave apo në lidhje me kryerjen e detyrave të AKI-së sipas këtij ligj.

3.5 Qeveria e Kosovës ka të drejtë nëpërmjet rrugës gjyqësore të rikthejë çfarëdo shume të paguar në emër të kompensimit palës së tretë, nëse punonjësi i AKI-së shpallet përgjegjës për dëmet të përmendura në nenin 3.4 më lartë, dhe nëse dëmet rezultojnë nga pakujdesia e madhe apo veprimi i qëllimshëm apo i paautorizuar i punonjësit.

Neni 4

Verifikimi dhe aktivitetet tjera të sigurimit

4.1 AKI-ja do të mbrojë sigurinë e aktiviteteve, informacionit, punonjësve dhe pronës së vet nëpërmjet mjeteve përkatëse, duke përfshirë verifikimin e kandidatëve, të punonjësve dhe të kontraktuarve sipas nevojës.

4.2 Të gjitha veprimet në lidhje me procedurat e verifikimit të përshkruara më lartë, dhe në Nenin 14 më poshtë, do të kryhen me konfidencialitet dhe për të vetmin qëllim, mbrojtjen e sigurisë së Kosovës dhe të popullit të saj.

4.3 Asnjë aplikant, punonjës apo i kontraktuar nuk do të diskriminohet mbi bazë të përkatësisë së vet në një komunitet apo në ndonjë mënyrë tjetër, e cila shkel nenin 2.4 të këtij ligji.

KREU II

ORGANIZIMI I ADMINSTRIMI I AKI-së

Neni 5

Drejtori i AKI-së

5.1 Drejtori i AKI-së, në pajtueshmëri me këtë Ligj, Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm dhe ligjet tjera në fuqi, është përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhimit të AKI-së. Drejtori i AKI-së do t'i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeministrit.

5.2 Në kryerjen e përgjegjësive të veta, drejtori i AKI-së ndihmohet nga një zëvendës drejtor, udhëheqësit e njësive organizative, këshilltarët, dhe personeli me kualifikim të duhur sipas

nevojës, në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e parashtruara me këtë Ligj dhe Rregulloren e Organizimit të Brendshëm.

5.3 Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emërojnë së bashku Drejtorin e AKI brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë.

5.4 Drejtori i AKI-se shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar.

5.5 Drejtori i AKI-së emërohet për një mandat pesë (5) vjeçar, i cili mund të vazhdohet edhe njëherë.

5.6 Drejtori i AKI-së duhet të ketë arsimim universitar dhe duhet të emërohet mbi baza të profesionalizmit dhe përvojës së dëshmuar.

5.7 Drejtori i AKI-së:

(i) shërben si këshilltar i Presidentit dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës për çështje të inteligjencës që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës;

(ii) njofton Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës për aktivitetet e AKI-së;

(iii) ofron informata për Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës sa i përket sigurisë;

(iv) është përgjegjës për mbledhjen, analizën, prodhimin dhe shpërndarjen e informatave dhe siguron se kjo bëhet me kohë dhe në mënyrë objektive dhe të pandikuar nga arsyet politike;

(v) mbron burimet e inteligjencës dhe metodat e veprimit si dhe informacionin tjetër të klasifikuar nga shpalosja e pa autorizuar;

(vi) ka pushtet ekskluziv të emërojë Punonjësit në AKI, që do të bëhet sipas parimeve të parashtruara në Kapitullin IV të këtij Ligji, dhe në Rregulloren e Organizimit të Brendshëm;

(vii) vendosë dhe koordinon marrëdhëniet me agjencitë e inteligjencës dhe sigurisë të qeverive të huaja për çështje që kanë të bëjnë me inteligjencën;

(viii) siguron se AKI-ja nuk ndërmer asnjë veprim që mund të krijojë dyshim të arsyeshëm se AKI-ja është e angazhuar në avancimin, mbrojtjen apo dëmtimin e interesave të cilido komunitet apo cilëndo parti apo organizatë politike;

(ix) siguron se AKI-ja nuk ndërmer asnjë veprim me qëllim të ndikimit në procese politike, opinion publik, politika dhe media në Kosovë;

(x) propozon buxhetin vjetor të bazuar në udhëzimet nga Platforma e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë dhe dorëzon propozimin bashkë me mendimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë për përfshirje në buxhetin vjetor të Kosovës;

(xi) përgatitë raporte dhe propozojë plane dhe programe të AKI-së, duke përfshirë mes tjerash, Programin Vjetor të Aktivitetit dhe Raportin Vjetor të Aktivitetit;

(xii) përgatitë propozimin e Platformës Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë;

(xiii) inicion dhe nënshkruan Memorandume të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me institucione dhe organe tjera;

- (xiv) raporton para Komisionit parlamentar mbikëqyrës sipas kërkesës; dhe,
- (xv) përgjigjet ndaj ankesave të individëve që besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga ana e AKI-së.

Neni 6

Zëvendësdrejtori i AKI-së

6.1 Zëvendësdrejtori i AKI-së ndihmon drejtorin e AKI-së dhe drejton aktivitetet operacionale të njësive organizative të AKI-së nën mbikëqyrjen e drejtorit të AKI-së.

6.2 Zëvendësdrejtori i AKI-së duhet të ketë arsimim universitar dhe emërohet mbi baza të profesionalizmit dhe përvojës së dëshmuar dhe pa marr parasysh përkatësinë politike, për një mandat pesëvjeçar (5), cili mund të përtërihet dhe do të rrjedhë pavarësisht nga mandati i drejtorit të AKI-së.

6.3 Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emërojnë zëvendës Drejtorin e AKI-së brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë.

6.4 Zëvendësdrejtori i AKI-së shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar.

6.6 Zëvendësdrejtori i AKI-së përkohësisht kryen dhe ushtron përgjegjësitë e drejtorit të AKI-së gjatë mungesës apo paaftësisë të drejtorit. Në rast të paaftësisë të përhershme, zëvendësdrejtori i AKI-së kryen dhe ushtron përgjegjësitë e drejtorit të AKI-së deri në kohën kur zëvendësimi i Drejtorit të KIA-s emërohet në mënyrë formale.

Neni 7

Rregullorja dhe Organizimi i Brendshëm

7.1 Organizimi i brendshëm i AKI-së përcaktohet me Rregulloren e Organizimit të Brendshëm.

7.2 Rregullorja e Organizimit të Brendshëm do t'i dorëzohet për miratim Kryeministrit.

7.3 Në pajtim me këtë Ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi, Drejtori i AKI-së është përgjegjës për shpalljen, mes tjerash, rregullat, rregulloret dhe udhëzimeve me sa vijon:

- (i) kodi i etikës;
- (ii) plani për sigurinë e të dhënave;
- (iii) rregullorja e klasifikimit dhe deklasifikimit të të dhënave;
- (iv) rregullorja e procedurës për lejen e sigurisë;
- (v) rregullorja për sigurimin e të dhënave sekrete dhe ruajtjen e të dhënave;

- (vi) rregulloret mbi shpërndarjen e të dhënave;
- (vii) rregullorja mbi rekrutimin, menaxhimin dhe pagimin e informatorëve;
- (viii) rregullorja mbi zbatimin, përdorimin dhe angazhimin e mjeteve operacionale speciale dhe teknike;
- (ix) rregullorja mbi mbajtjen dhe përdorimin e armëve;
- (x) rregullorja e punës;
- (xi) rregullorja për pagat;
- (xii) rregullorja e sigurisë së brendshme;
- (xiii) rregullorja e procedurës disiplinore;
- (xiv) rregullorja mbi thirrjet bazike dhe të përgjithshme të punonjësve të AKI;
- (xv) rregullorja mbi bashkëpunimin me organe dhe institucione;
- (xvi) rregullorja mbi nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit me organe dhe institucione në Kosovë;
- (xvii) rregullorja mbi bashkëpunimin me organe ndërkombëtarë dhe shkëmbimin e inteligjencës;
- (xviii) rregullorja e kartelat identifikuese;
- (xix) rregulloren mbi mekanizmin e ankesave, që do të zhvillohet në konsultim me institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe do të vendoset në domenin publik.

7.4 Përmbledhjet e rregullave, rregulloret, dhe udhëzimet të parashtruara në Nenin 7.3 të këtij Ligji do të jenë të klasifikuara në atë mënyrë që të jenë në interes të sigurisë së Kosovës.

7.5 Drejtori i AKI siguron që të punësuarit në AKI të jenë të njohur me Përmbledhjet e Rregullave, rregulloret dhe udhëzimet e nxjerra në bazë të nenit 7.3 dhe dispozitave tjera të këtij ligji.

Neni 8

Bashkëpunimi brenda qeveritar

8.1 Bashkëpunimi ndërmjet AKI-së dhe Policisë së Kosovës, Ministrisë për Punë të Brendshme, si dhe me institucionet tjera të sigurisë publike do të jetë i rëndësishëm primare. AKI-ja bashkëpunon me institucionet tjera qeveritare në Kosovë me qëllim të mbrojtjes së zyrtarëve, objekteve dhe informacionit të AKI-së.

8.2 Pas emërimit të drejtorit të AKI-së, nënshkruhet një memorandum për bashkëpunim, ndihmë dhe koordinim të ndërsjellë të aktiviteteve ndërmjet AKI-së dhe Policisë së Kosovës, Ministrisë për Punë të Brendshme dhe institucioneve tjera relevante qeveritare. Qeveria definon parimet e përgjithshme të koordinimit dhe asistencës ndërmjet dhe brenda AKI-së dhe organeve dhe institucioneve në Kosovë.

8.3 AKI-ja dhe organet dhe institucionet tjera në Kosovë janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën në kryerjen e detyrave të tyre dhe të koordinojnë aktivitetet brenda kompetencave të veta, në harmoni me ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me mbrojtjen e burimeve, metodave dhe informacionit tjetër të klasifikuar.

8.4 Drejtori i AKI-së, me miratim të kryeministrit, bënë marrëveshje me institucionet në Kosovë për ofrimin e mbështetjes për inteligjencën e fshehtë.

KREU III

INSPEKTORI I PËRGJITSHËM

Neni 9

Emërimi dhe mandati i inspektorit të përgjithshëm

9.1 Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emëron Inspektorin e Përgjithshëm të AKI-së brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë.

9.2 Inspektori i përgjithshëm shërben për një mandat (4) katërvjeçar, që mund të përtërihet edhe për një mandat katërvjeçar.

9.3 Inspektori përgjithshëm shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar.

9.4 Emërimi i inspektorit të përgjithshëm bëhet mbi baza të integritetit, përputhjes ndaj standardeve të sigurisë së AKI-së, dhe përvojës në lëmi të sigurisë apo administrimit qeveritar në Kosovë.

9.5 Inspektori i përgjithshëm i raporton drejtpërdrejt kryeministrit.

9.6 Inspektori i përgjithshëm i raporton organit mbikëqyrës parlamentar të paktën çdo gjashtë (6) muaj dhe me kërkesë specifike me shkrim të Komisionit Mbikëqyrës Parlamentar.

Neni 10

Përgjegjësia e inspektorit të përgjithshëm

10.1 Inspektori i përgjithshëm inspekton aktivitetet e AKI-së.

10.2 Është përgjegjësi e inspektorit të përgjithshëm të ndihmojë drejtorin të jetë informuar në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme për problemet potenciale në aktivitetet e AKI-së, me qëllim të promovimit të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, dhe evitimit të çfarëdo shkeljeje ligjore.

10.3 Inspektori i përgjithshëm i rekomandon Drejtorit të AKI-së veprime korrektuese dhe monitoron progresin e secilit veprim korrektuese të urdhëruar nga drejtori i AKI-së.

10.4 Përgjegjësia e inspektorit të përgjithshëm përfshin auditimet financiare të aktiviteteve të AKI-së. Përveç drejtorit të AKI-së, rezultatet e këtyre auditimeve do t'i vihen në dispozicion edhe kryeministrit.

10.5 Pas njoftimit të drejtorit të AKI-së, inspektori i përgjithshëm ka të drejtë të marrë në pyetje Punonjësit e AKI-së dhe të ketë qasje në objektet dhe të dhënat e AKI-së sipas nevojës, me qëllim të hetimit, inspektimit apo auditimit të brendshëm.

10.6 Drejtori i AKI-së mund t'i ndalojë inspektorit të përgjithshëm të iniciojë, kryejë apo përfundojë cilindo inspektim apo auditim nëse drejtori përcakton se është e nevojshme të mbrohen interesat vitale të sigurisë së Kosovës. Nëse drejtori ushtron këtë të drejtë, ai apo ajo do t'ia raportojë këtë veprim kryeministrit dhe Presidentit të Republikës së Kosovës brenda shtatë (7) ditëve kalendarike.

10.7 Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për ofrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm në AKI duke shqyrtuar aktivitetet e AKI-së, iniciuar inspektime, auditime dhe hetime, hetuar ankesat në lidhje me aktivitetet e AKI-së apo të bëra nga personat në Kosovë.

10.8 Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për të mbështetur hetimet e Ombudspersonit të Kosovës

Neni 11

Ndihma inspektorit të përgjithshëm

Nëse e miraton drejtori i AKI-së, inspektori i përgjithshëm bënë zgjedhjen e individëve për ta ndihmuar atë në kryerjen e funksioneve të veta, duke përfshirë individë të kualifikuar për të kryer auditime financiare.

KREU IV

PUNONJËSIT E AGJENCISË SË INTELEKJENCËS SË KOSOVËS

Neni 12

Zbatueshmëria e legjislacionit të punësimit për punonjësit e AKI-së

12.1 Punonjësit e AKI-së nuk janë shërbyes civilë. Megjithatë, legjislacioni që rregullon çështjet e shërbimit civil zbatohet ndaj AKI-së, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe me këtë ligj.

12.2 Shpalljet e vendeve të lira të punës në AKI i nënshtrohen konkurrencës së hapur dhe publikohen në shumë gazeta ditore që shpërndahen në Kosovë, me përshkrim të kërkesave të përgjithshme për pozitat në pajtim me ligjin në fuqi.

12.3 Procesi i brendshëm i zgjedhjes të punonjësve të AKI-së do të jetë i klasifikuar.

Neni 13

Kushtet specifike për punonjësit e AKI-së

13.1 Përveç kërkesave të përgjithshme për punësim që zbatohen ndaj punonjësve të tjerë të qeverisë, drejtori i AKI-së mund të vë kushte speciale për punonjës të AKI-së në lidhje me ekspertizën, shëndetin, detyrat e punës, dhe kërkesat e sigurisë që janë në përputhje me interesat e sigurisë së Kosovës.

13.2 Rregullorja e Organizimit të Brendshëm, e hartuar nga drejtori i AKI-së, përcakton kërkesat për secilën pozitë në AKI, si dhe do të parashtrojë kërkesat specifike për punësim në AKI.

13.3 Në përputhje me rregullat e brendshme dhe kur është e nevojshme, AKI mund të kontraktojë palë të treta për shërbime ndihmëse.

Neni 14

Leja e sigurisë

14.1 Personat e zgjedhur për punësim në AKI duhet të plotësojnë standardet strikte të sigurisë, të cilat përcaktohen në pajtim me ligjin në fuqi dhe në harmoni me procedurat e përcaktuara në rregulloret e shpallura nga drejtori i AKI-së dhe të miratuara nga Qeveria. Kandidati duhet të vlerësohet stabil, i besueshëm dhe me karakter, vlerësim dhe diskrecion të shkëlqyeshëm. Çfarëdo dyshimi në lidhje me cilindo nga faktorët e sipërpërmendur zgjidhet në favor të sigurisë së Kosovës dhe leja e sigurisë do të refuzohet.

14.2 Kandidatët nuk punësohen nga AKI-ja nëse nuk i nënshtrohet procedurës së lejes së sigurisë ose dështojnë të plotësojnë kërkesat e parashtruara në nenin 15.

14.3 Kandidatët të cilët qëllimisht paraqesin informata të rreme eliminohen automatikisht.

14.4 Nëse personi nuk punësohet në AKI pasi që ai apo ajo dështon të plotësojë kërkesat e sipërpërmendura ose nëse ka pengesa për këtë punësim, AKI-ja i shpjegon arsyet për të cilat personi nuk është punësuar, përveç nëse shpalosja e informacionit të tillë rezulton në komprometimin e informacionit të klasifikuar.

Neni 15

Kualifikimet për punësim në AKI

AKI nuk mund të rekrutojë kandidatët nëse nuk i plotësojnë kushtet në vijim:

- (i) të jenë shtetas të Kosovës;
- (ii) të jenë mbi 18 vjeç;
- (iii) të kenë kualifikime të duhura arsimore dhe profesionale ashtu siç përcaktohet me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm;
- (iv) të kryejnë ekzaminimin mjekësor të kërkuar për pozitë;

- (v) të jenë të liruar nga shërbimi ushtarak, nëse është e zbatueshme; dhe
- (vi) të jenë të aftë të plotësojnë kërkesat e sigurisë që do të përcaktohen me anë të procedurës për lejen e sigurimit.

Neni 16

Të drejtat e punonjësve të AKI-së

16.1 Punonjësit e AKI-së kanë të drejtë për:

- (i) për punësim të përhershëm deri në plotësimin e kushteve për pensionim, me përjashtim të individëve të cilët janë të punësuar në bazë të kontratës për shërbim për një periudhë fikse, si dhe atyre që shkarkohen me arsyë, në bazë të legjislacionit në fuqi;
- (ii) të merr pushim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mundësinë për të vazhduar punën e njëjtë apo të ngjashme kur të mbarojë pushimi;
- (iii) për shpërblim për detyrat dhe kryerjen e detyrave siç përcaktohet me këtë ligj;
- (iv) të merr rrogë dhe pagesa në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- (v) për avancim të karrierës dhe zhvillim profesional nëpërmjet trajnimit dhe mjeteve tjera;
- (vi) për mbrojtje të integritetit fizik dhe moral gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare.

16.2 Kur një Punonjës i AKI-së beson se shpalojta në gjyq e informacionit, të cilin e ka mësuar për shkak të punësimit të tij në AKI mund të dëmtojë sigurinë e Kosovës, ai do t'ia referojë çështjen gjyqtarit kryesor. Gjyqtari kryesor konsultohet me inspektorin e përgjithshëm dhe ai mban autoritetin final mbi përdorimin e informacionit në gjyq dhe vendosjes nëse procedura *in camera* është e nevojshme për procesin.

16.3 Nëse iniciohen procedura gjyqësore kundër një Punonjësi të AKI-së për shkak të veprimeve të kryera gjatë kryerjes së detyrave të AKI-së, AKI-ja siguron avokat apo ndihmë tjetër juridike për Punonjësin, përveç nëse Punonjësi ka vepruar jashtë autorizimeve të veta apo ka keqpërdorur autorizimet e veta.

16.4 Sipas të njëjtave kushte nga neni 16.3 më lartë, AKI-ja, po ashtu, siguron ndihmë juridike për një Punonjës pas përfundimit të punësimit të tij/saj, përveç nëse Punonjësi ka të drejtë tjetër për ndihmë juridike ekuivalente.

Neni 17

Sjelljet e ndaluara të Punonjësit

17.1 Punonjësit e AKI-së nuk mund të jenë anëtarë të partive politike apo marrin udhëzime prej partive, organizatave apo lëvizjeve politike, apo individëve jashtë AKI-së, e as nuk mund të kryejnë çfarëdo aktiviteti apo detyra tjera publike apo profesionale me pagesë, të cilat nuk janë në përputhje me punën e AKI-së. Punonjësit e AKI-së kërkojnë miratimin paraprak të drejtorit të AKI-së para së t'i bashkohen cilësdo organizate apo grupi; dështimi për të raportuar këtë mund të ofrojë bazë për suspendim apo përjashtim të Punonjësit të AKI-së.

17.2 Punonjësit e AKI-së nuk mund të kenë punësim tjetër gjatë kohës sa janë të punësuar të AKI-së.

17.3 Punonjësit e AKI-së nuk kanë të drejtën për veprime që kanë për qëllim ndërprerjen e aktivitetit apo ndonjë formë tjetër të ndalesës kolektive të punës.

17.4 Punonjësit e AKI-së, pa pajtimin paraprak të drejtorit të AKI-së, nuk mund të japin deklarata publike apo përndryshe komentojnë punën e AKI-së, apo ofrojnë informacione personave të paautorizuar mbi të dhënat, dokumentet, kontaktet, qëllimet, dijen apo personelin e AKI-së.

17.5 Punonjësit e AKI-së nuk do të ndjekin apo pranojnë asnjë fitim, beneficion, avancim monetar, apo shërbim për vete apo të tjerët përveç atyre të ofruara me këtë Ligj.

17.6 Shkelja e cilësdo dispozitë të këtij neni apo këtij Ligji konsiderohet bazë për suspendim dhe/apo ndërprerje të punësimit sipas këtij Ligji.

Neni 18

Detyrimet ligjore personale të punonjësit

18.1 Secili punonjës i AKI-së do t'i kryej detyrat që i jepen në pajtim me këtë ligj dhe ligjet tjera relevante dhe është personalisht përgjegjës për zbatimin e ligjshëm të detyrave të AKI-së, ashtu siç është përcaktuar me këtë Ligj, dhe që janë në kuadër të detyrave të dhëna punonjësit të caktuar.

18.2 Nëse një punonjës beson se ai apo ajo ka pranuar një urdhër ilegal, ai apo ajo duhet të informojë urdhërdhënësin në lidhje me shqetësimin e tij apo të saj.

18.3 Në rastet kur urdhërdhënësi përsërit urdhrin, Punonjësi do të kërkojë një konfirmim me shkrim të urdhrit të tillë. Nëse Punonjësi vazhdon të ketë rezervime, ai apo ajo do t'ia përcjellë urdhrin eprorit të parë të urdhërdhënësit dhe do t'ia raportojë çështjen inspektorit të përgjithshëm.

18.4 Punonjësi duhet të refuzojë të kryejë një urdhër për të cilin ai apo ajo beson me arsye se shkel ligjin e zbatueshëm të Kosovës.

18.5 Nëse një Punonjës beson se AKI-ja apo një Punonjës i AKI-së mund të ketë shkelur apo po shkel ndonjë ligj, rregullore apo politikë relevante, ai apo ajo duhet t'ia raportojë këtë inspektorit të përgjithshëm.

18.6 Punonjësi nuk mund t'u nënshtrohet procedurave disiplinore për kryerjen e veprimeve sipas neneve 18.2, 18.3, 18.4 ose 18.5 të këtij Ligji përveç nëse Inspektori i përgjithshëm vendosë ndryshe.

Neni 19

Pagat dhe kompensimi për punonjësit e AKI-së

19.1 Krijimi i një pakoje kompensimi për Punonjësit e AKI-së njih kushtet e veçanta nën të cilat ata kryejnë detyrat e veta. Rroga bazë e punonjësve të AKI-së ndryshon bazuar në faktorë që përfshijnë, por nuk kufizohen në, gradën dhe kohëzgjatjen e shërbimit.

19.2 Përveç rrogës bazë, Punonjësit e AKI-së mund të pranojnë ligjërisht lloje të ndryshme të shtesave të rrogës, mëditjeve dhe beneficioneve. Këto pagesa shtesë mund të bazohen në faktorë që përfshijnë, por nuk kufizohen në, detyrën me rrezik, punën pas orarit, ndryshimin për punën me ndërrime, punën gjatë festave dhe ditëve tjera që zakonisht do të ishin ditë pushimi, detyrat speciale dhe shkathtësitë speciale.

19.3 Pagesat shtesë mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në, shtesën për rrezik, shtesën për ndërrim, pagesën për ditë festash, pagesën për punën pas orarit dhe pagesën për detyra speciale. Beneficionet mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnim profesional dhe teknik, shpenzimet e jetesës për transfer të përkohshëm apo detyrë speciale, pushim të paguar, beneficione të vdekjes dhe beneficione të pensionit.

19.4 Rrogat bazë dhe cilado pagesa të autorizuar shtesë përcaktohen dhe paguhet në pajtim me procedurat e definuara me ligjin përkatës në fuqi dhe aktet nënligjore të Qeverisë. Nëse e miraton Kryeministri, Drejtori i AKI-së mund të përfshijë në propozimin për buxhetin vjetor për Punonjësit e AKI-së, shumat që do të përdoren për pagesën e cilësdo pagesë shtesë të autorizuar me ligj.

19.5 Mbahet evidencë e të gjitha rritjeve të rrogave sipas këtij Neni dhe ajo shqyrtohet periodikisht nga inspektori i përgjithshëm i AKI-së.

Neni 20

Dispozitat disiplinore dhe ndërprerja e punësimit

20.1 Punonjësit mund të shpallen përgjegjës për shkelje të detyrës zyrtare ashtu si parashtrohet me këtë Ligj.

20.2 Procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore brenda AKI-së udhëhiqen nga procedurat e brendshme.

20.3 Punësimi i punonjësve të AKI-së ndërpritet në këto raste:

- (i) dorëheqja vullnetare nga AKI-ja;
- (ii) përfundim i kontratës;
- (iii) arritja e moshës së pensionimit;
- (iv) paaftësia e përhershme për kryerjen e detyrave zyrtare për shkak të kushteve shëndetësore, me kusht që Punonjësi nuk ka të drejtë të transferohet në një pozitë tjetër të përshtatshme brenda AKI-së;
- (v) humbja e shtetësisë së Kosovës;

- (vi) marrja vullnetare e shtetësisë së një vendi tjetër pas fitimit të punësimit në AKI;
- (vii) shkurtimet e vendeve të punës;
- (viii) dënimi për vepër penale që bart ndëshkim me burg; dhe
- (ix) përjashtimi nga shërbimi si rezultat i procedurës disiplinore.

Neni 21

Kartelat e identifikimit

Punonjësve të AKI-së ju lëshohen kartelat e identifikimit. Lloji, forma dhe përmbajtja e kartelës së identifikimit të Punonjësit të AKI-së përcaktohet me rregullore të lëshuar nga drejtori i AKI-së pas konsultimit me kryeministrin.

Neni 22

E drejta për armëmbajtje

22.1 Punonjësit e AKI-së zakonisht nuk mbajnë armë.

22.2 Punonjësit e AKI-së autorizohen të mbajnë armë vetëm nëse drejtori i AKI-së beson me arsye se është e nevojshme për mbrojtjen personale të personelit të AKI-së.

22.3 Autorizimet e armëve do të:

- (i) regjistrohen në formë të shkruar;
- (ii) lëshohen për një periudhë të kufizuar kohore; dhe
- (iii) nënshtrohen shqyrtimit të inspektorit të përgjithshëm.

22.4 Drejtori i AKI-së harton udhëzime të qarta për mbajtjen dhe përdorimin e armëve që përfshijnë trajnimin dhe testimin e nevojshëm për t'u kualifikuar për autorizim për armëmbajtje. Të gjithë Punonjësit e autorizuar për armëmbajtje duhet së pari të jenë të kualifikuar për mbajtjen e asaj arme.

KREU V

MBLEDHJA, NDARJA DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT

Neni 23

Mbledhja e informacionit

23.1 AKI është e autorizuar të mbledhë, mbajë dhe shpërndajë për qëllime të ligjshme qeveritare informacion sipas nenit 2 të këtij Ligji. Këto aktivitete rregullohen me procedura

strikte në pajtueshmëri me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe nevojës, dhe vetëm për avancim të sigurisë kombëtare. I gjithë informacioni i mbledhur në këtë mënyrë klasifikohet në një mënyrë që përcaktohet si e përshtatshme nga drejtori i AKI-së dhe në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtjen dhe klasifikimin e informacionit.

23.2 Procedura e përmendur më lartë lejon mbledhjen e informacionit i cili përfshinë, por nuk kufizohet në informacionin e mbledhur gjatë aktivitetit të ligjshëm të inteligjencës; informacionin që del nga hetimi i ligjshëm i personelit ose sigurimit fizik; ose informacioni që ka të bëjë me personat për të cilët ka arsye të besohet se janë burime apo kontakte potenciale me qëllimin e vetëm të përcaktimit të përshtatshmërisë ose besueshmërisë të tyre.

Neni 24

Burimet e informacionit

Në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të veta, AKI-ja mund:

- (i) të mbledhë informacion duke fshehur arsyet për mbledhjen e tij për shkak të natyrës sekrete të tij;
- (ii) të krijojë kontakte të fshehta me individë privatë;
- (iii) të krijojë dhe përdorë sisteme informacioni për avancimin e mbledhjes së inteligjencës;
- (iv) të përdorë forma të mashtrimit operativ që nuk shkaktojnë lëndime fizike apo dëmtojnë shëndetin;
- (v) të përgatisë dhe përdorë dokumente mbulesë për mbrojtjen e punonjësve të AKI-së dhe personave fizikë që bashkëpunojnë me ta, si dhe fshehjen e qëllimit të sigurisë së tyre;
- (vi) të krijojë dhe mbajë organizata të përkohshme për qëllime të mbledhjes së fshehtë të të dhënave; dhe
- (vii) të caktojë punonjës të AKI-së të punojnë në fshehtësi në institucione apo organe të Kosovës “në pajtim me nenin 8.4 të këtij ligji”.

Neni 25

Shpërndarja e informacionit

25.1 Drejtori i AKI-së ose i emëruari i tij/saj, sipas nevojës aprovojnë shpërndarjen rezultateve të analizave të tij tek institucionet tjera qeveritare në periudha të caktuara dhe në pajtueshmëri me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

25.2 Nëse gjatë kryerjes së funksioneve të veta, AKI-ja bindet se ekziston bazë për dyshim se një person apo subjekt i caktuar ka kryer apo po kryen një vepër penale, apo po përgatitë apo organizon një vepër penale që i nënshtrohet ndjekjes publike, ajo është e obliguar të njoftojë drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe prokurorin publik kompetent.

25.3 Nëse një rast që del nga Neni 25.2 më lartë, përfshinë dyshimin për një vepër penale kundër sigurisë së Qeverisë së Kosovës dhe rendit të saj kushtetues, drejtori i AKI-së mund t'i paraqesë një kërkesë prokurorit publik kompetent që policia të suspendojë përkohësisht ekzekutimin e akteve dhe masave në procedimet parapenale kur kjo është në interes të sigurisë kombëtare dhe kur jetët dhe shëndeti i personave të tretë me këtë nuk vihen në rrezik.

Neni 26

Përkrahja nga institucionet tjera qeveritare

Institucionet qeveritare bashkëpunojnë dhe ndihmojnë AKI, përveç nëse ligji përjashton këtë mundësi, nën mbikëqyrjen e kryeministrit.

Neni 27

Përkrahja institucioneve tjera qeveritare

AKI mund të ofrojë përkrahje në fushë të inteligjencës, duke përfshirë edhe ndihmë të ekspertëve, institucioneve tjera qeveritare sipas nevojës për sigurinë e Kosovës.

Neni 28

Urdhri gjyqësor për përgjim apo hyrje në objekte

28.1 Përgjimi në vende jopublike, apo ku palët mund të presin me arsye të kenë privatësi, përgjimi i telekomunikacioneve, dhe të gjitha format tjera të përgjimit elektronik, si dhe hyrja në pronë pa pajtimin e pronarit apo banuesit të përkohshëm, mund të bëhet vetëm në rastet kur ka pasur autorizim paraprak nga një gjyqtar i Gjykatës Supreme që do të jepet vetëm pas shqyrtimit të kërkesës më shkrim të bërë nën betim dhe të aprovuar nga drejtori i AKI-së apo zëvendës drejtori i AKI-së.

28.2 Gjyqtari i Gjykatës Supreme është i detyruar të ruaj fshehtësinë në lidhje me informacionin e fituar sipas dispozitave të këtij Ligji.

28.3 Drejtori i AKI-së paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të Gjykatës Supreme kur ai apo ajo beson me arsye se nevojitet përgjimi apo hyrja për të mundësuar AKI-në të hetojë çështje brenda brezit të veprimeve të veta.

28.4 Zbatimi dhe urdhri për përgjim të fshehtë ofrojnë:

- (i) emrin dhe adresën apo përshkrimin preciz fizik të cakut apo caqeve;
- (ii) llojin e komunikimit që duhet përgjuar, llojin e informacionit, shënimet, dokumentet apo gjërat që propozohen të merren; dhe mjetet që duhen ushtruar për atë qëllim;
- (iii) një përshkrim të përgjithshëm të vendit apo vendeve kur përgjimi apo kërkimi propozohet të kryhet, nëse mund të jepet një përshkrim i përgjithshëm i atij vendi;

- (iv) arsyetimin për pohimin se teknika që kërkohet të përdoret nevojitet që t'i mundësojë AKI-së të mbledhë inteligjencë lidhur me një kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës;
- (v) informacionin që arsyeton se përgjimi apo kërkimi kërkohet mbi baza të arsyeshme për t'i mundësuar AKI-së të hetojë një kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës;
- (vi) një deklaratë se informacioni i kërkuar nuk mund të merret në mënyrë të arsyeshme nëpërmjet një teknike më pak ndërhyrëse brenda kohës së nevojshme;
- (vii) periudhën, jo më të gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë, për të cilën kërkohet që urdhri të jetë në fuqi; *dhe*
- (viii) informacionin për cilëndo kërkesë të mëparshme të bërë në lidhje me personin apo vendin që i nënshtrohen përgjimit apo kërkimit, datën në të cilën një kërkesë e tillë është bërë, emrin e gjyqtarit të cilit i është paraqitur kërkesa; dhe vendimin e gjyqtarit në atë rast.

28.5 Teknikat e përgjimit do të përdoren në pajtueshmëri me standardet të parapara për të minimizuar marrjen, mbajtjen dhe shpërndarjen e informacionit jo relevant për qëllimin e deklaruar të urdhrin për përgjim.

28.6 Gjyqtari merr një vendim brenda dyzetetë (48) orësh prej paraqitjes së kërkesës.

28.7 Urdhri për përgjim i gjyqtarit përcakton periudhën kohore gjatë së cilës aprovohet teknika, e cila nuk do të zgjasë me tepër se gjashtëdhjetë (60) ditë. Zgjatjet e një urdhri mund të jepen pas një kërkesë për zgjatje të bërë në mënyrën e njëjtë si ajo e përshkruar në Nenin 28.2, duke paraqitur arsyetimin për zgjatjen e propozuar.

28.8 Përdorimi i një teknike përgjimi ndërpritet menjëherë nëse objektivat e parashtruara në urdhrin e gjyqtarit janë arritur apo nëse nuk mund të priten rezultate të mëtejme nga përdorimi i vazhduar i saj.

Neni 29

Urdhri për përgjim emergjent

Në një situatë emergjente, kur koha nuk lejon përgatitjen e një kërkesë me shkrim nga ana e drejtorit të AKI-së apo zëvendësdrejtorit të AKI-së apo dhënien e një urdhri me shkrim nga ana e një gjyqtari të Gjykatës Supreme, kërkesa mund të bëhet dhe urdhri për përgjim të fshehtë mund të jepet gojarisht, për t'u konfirmuar më shkrim brenda dyzetetë (48) orësh.

Neni 30

Qasja në të dhënat personale të mbajtura nga një palë e tretë

30.1 Sipas këtij neni, AKI-ja mund marr të dhëna personale të mbajtura nga pala e tretë.

30.2 Pas kërkesës së një pjesëtari të AKI-së, drejtori mund të autorizojë kërkesat që një palë e tretë të ofrojë informacion të atillë siç përshkruhet në shkresën ligjore, nëse ai konsideron se ka nevojë të arsyeshme për të avancuar përgjegjësitë e AKI-së të parapara në nenin 2.1.

30.3 Pala e tretë mund të pajtohet me kërkesat e shkresës ligjore por nuk është nën asnjë obligim të bëjë këtë. Kur pala e tretë nuk pajtohet apo nuk ka gatishmëri të pajtohet me tërë shkresën ligjore, ata mund të pajtohen me një përgjigje të pjesshme.

30.4 Një palë e tretë mund të kërkojë kompensim përkatës për plotësimin e kërkesave të shkresës ligjore. Zbatimi i kërkesave të shkresës ligjore nuk mund të vonohet për të fituar kompensimin përkatës.

30.5 Kërkesa e përmendur në nenin 30.2 duhet të përfshijë:

- (i) emrin dhe adresën ose përshkrimin preciz fizik të caktuar apo caqeve;
- (ii) informacionin që kërkohet;
- (iii) kohën kur kërkohet informacioni;
- (iv) formatin në të cilin kërkohet informacioni;
- (v) emrin dhe adresën e palës së tretë e cila ka informacionin që kërkohet;
- (vi) informacion që arsyeton se informacioni kërkohet mbi baza të arsyeshme për t'i mundësuar AKI-së të hetojë një kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës;
- (vii) një deklaratë se informacioni i kërkuar nuk mund të sigurohet më mënyrë të arsyeshme nëpërmjet një teknike më pak ndërhyrëse brenda kohës së nevojshme; dhe
- (viii) informacion mbi cilëndo kërkesë të mëparshme të bërë në lidhje me cakun e shkresës ligjore, datën në të cilën një kërkesë e tillë është bërë, dhe vendimin në atë rast.

30.6 Shkresa ligjore në këtë nen 30.2 duhet të jetë në format të përcaktuar dhe përmbajë informacionin vijues:

- (i) faktin se është një shkresë ligjore sipas Nenit 30 të këtij ligji;
- (ii) faktin se pala e tretë ka të drejtë për kompensim përkatës;
- (iii) si mund të kërkojë pala e tretë pagesën e kompensimit përkatës;
- (iv) faktin se pajtueshmëria me shkresën ligjore është vullnetare.

30.7 Autoritetet nuk i kërkojnë palës së tretë të mbledhë informacion të cilin ata përndryshe do të mblidhnin gjatë aktiviteteve të tyre normale dhe ligjore.

30.8 Pala e tretë nuk do të shpalosë ekzistencën e autorizimit me shkrim, ose cilindo informacion që mund të zbulojë ekzistencën e autorizimit me shkrim asnjë personi të paautorizuar, përveç personave nga të cilët kërkohet përmbushja e kërkesave të autorizimit me shkrim.

Neni 31

Trajtimi i të dhënave të mbledhura dhe ruajtura

31.1 Të dhënat personale të mbledhura nga AKI-ja duhet të ruhen për qëllime të specifikuar dhe legjitime dhe nuk përdoren në cilëndo mënyrë që nuk është në pajtim me ato qëllime, dhe

duhet te mbahen nga AKI-ja vetëm gjatë kohës sa është e nevojshme për kryerjen e detyrave të saj. Në momentin kur është e panevojshme që të dhënat personale të mbahen nga AKI-ja, ato duhet të asgjësohen nga AKI-ja sipas mënyrës së përcaktuar me rregulla të brendshme.

31.2 Merren masat përkatëse të sigurisë për mbrojtjen e këtij informacioni të ruajtur në skeda të automatizuara të të dhënave nga shkatërrimit aksidental apo i joautorizuar, nga humbja aksidentale, si dhe nga qasja, ndryshimi dhe shpërndarja aksidentale.

KREU VI

FSHEHTËSIA

Neni 32

Raportimi i përjashtimit

Në avancim të autorizimeve dhe përgjegjësisë së drejtorit të AKI-së për mbrojtjen e burimeve dhe metodave të inteligjencës dhe informacionin tjetër të klasifikuar, AKI do të jetë e përjashtuar nga dispozitat e cilado ligjeve që kërkojnë shpalosjen e organizimit, funksioneve, emrave, titujve zyrtarë.

Neni 33

Obligimi i Punonjësve për Ruajtjen e Fshehtësisë

Punonjësit e AKI-së duhet të mbrojnë informacionin e klasifikuar dhe, si kusht punësimi, nënshkruajnë një marrëveshje ruajtjen e fshehtësisë. Obligimi për të mbrojtur këto fshehtësi nuk pushon kur Punonjësi nuk është më i punësuar në AKI.

Neni 34

Ndjekja penale për zbulimin e paautorizuar të informatave të klasifikuara

Zbulimi i informatave të klasifikuara të AKI-së cilitdo individ të pa autorizuar për ta pranuar ato, paraqet shkelje të Kodit Penal të Kosovës, dhe kryesi do t'i nënshtrohet dënimit siç parashihet në dispozitën përkatëse të kodit.

KREU VII

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Neni 35

Mbikëqyrja parlamentare

Mbikëqyrja e KIA-s kryhet nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, mandati i të cilit përshkruhet me këtë ligj. Përbërja e tij përcaktohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës.

Neni 36

Veprimi dhe përgjegjësitë e organit mbikëqyrës parlamentar

- 36.1 Komisioni mbikëqyrës parlamentar mban mbledhjet e veta të paktën dy herë në vit.
- 36.2 Kryetari i komisionit mbikëqyrës parlamentar nuk duhet të jetë anëtar i partisë politike apo koalicionit qeverisës që është në pushtet.
- 36.3 Kryetari i komisionit mbikëqyrës parlamentar thirr mbledhjet me iniciativën e vet.
- 36.4 Kryetari i komisionit mbikëqyrës parlamentar është i obliguar të thirr mbledhjet e organit mbikëqyrës parlamentar pas marrjes së kërkesës me shkrim të një të tretës të anëtarëve të organit mbikëqyrës parlamentar sipas rregullores së punës në fuqi të Kuvendit të Kosovës.
- 36.5 Ndërveprimi ndërmjet AKI-së dhe komisionit mbikëqyrës parlamentar do të jetë i mbyllur për publik përveç nëse specifikohet ndryshe nga kryesuesi i komisionit mbikëqyrës parlamentar, sipas diskrecionit të tij apo saj, apo pas rekomandimit dhe votimit të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të komisionit mbikëqyrës parlamentar.
- 36.6 Komisioni mbikëqyrës parlamentar është përgjegjës të:
- (i) mbikëqyrë ligjshmërinë e punës së AKI-së;
 - (ii) shqyrtojë raportet e kryeministrit në lidhje me çështjet brenda kompetencave, të cilat përfshijnë veprime të ndërmarra për të korrigjuar çfarëdo problemesh në AKI të bëra të ditura nëpërmjet inspektimit, auditimit apo hetimit;
 - (iii) shqyrtojë raportet e drejtorit të AKI-së në lidhje me operacionet dhe shpenzimet e AKI-së;
 - (iv) shqyrtojë raportet e inspektorit të përgjithshëm;
 - (v) ofrojë një mendim për propozimin e detajizuar të buxhetit për AKI-në; dhe
 - (vi) kryejë hetime në lidhje me punën e AKI-së.

Neni 37

Hetimet parlamentare

- 37.1 Nëse komisioni mbikëqyrës parlamentar ka bazë të besojë se AKI-ja po kryen detyrat e veta në mënyrë të paligjshme, të papërshtatshme apo joprofesionale, ai mund të kryejë një hetim gjatë të cilit komisioni mbikëqyrës parlamentar mund të marrë në pyetje Punonjësit e AKI-së dhe të ketë qasje në dokumentet relevante të AKI-së.
- 37.2 Hetimet parlamentare janë të mbyllura për opinionin përveç nëse caktohet ndryshe nga kryesuesi i organit mbikëqyrës parlamentar, në bazë të diskrecionit të tij apo saj, ose pas rekomandimit dhe votimit të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të komisionit mbikëqyrës parlamentar.

37.3 Nëse komisioni mbikëqyrës parlamentar konstaton se operacioni i AKI-së është i paligjshëm, ai mund të ftojë kryeministrin të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të iniciojë shqyrtimin e përgjegjesisë.

37.4 Kryeministri është i obliguar të informojë komisionin mbikëqyrës parlamentar për rezultatet e çdo shqyrtimi të kryer sipas dispozitave të këtij Neni.

37.5 Gjatë kryerjes së funksionit të vet, komisioni mbikëqyrës parlamentar mund të kërkojë informacion nga kryeministri, drejtori i AKI-së, ose cilido Punonjës i AKI-së. Në avancim të këtij funksioni, komisioni mbikëqyrës parlamentar mund të urdhërojë drejtorin e AKI-së të paraqitet para tij në mënyrë që drejtori i AKI-së të japë raport gojor në lidhje me aktivitetet e AKI-së.

37.6 Gjatë mbikëqyrjes parlamentare të ushtruar nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, do të vihet në dispozicion informacion i klasifikuar përveç nëse shpalosja e tij do të kërcënonte interesat vitale të sigurisë kombëtare të lidhura me mbrojtjen e burimeve dhe metodave në një rast specifik.

37.7 Nëse Kryeministri apo drejtori i AKI-së vendosin të mos i ofrojnë informacion komisionit mbikëqyrës parlamentar në bazë të Nenit 36.5 më lartë, ai do të informojë menjëherë me shkrim komisionin mbikëqyrës parlamentar me shpjegimin për mosofrimin e atij informacioni.

Neni 38

Obligimi i ruajtjes së fshehtësisë nga komisioni mbikëqyrës parlamentar

38.1 Anëtarët e komisionit mbikëqyrës parlamentar janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë në me lidhje me informacionin që ka të bëjë me sekretet zyrtare në të cilat kanë pasur qasje në cilësinë e tyre, dhe e cila do të mbetet në fuqi pas përfundimit të anëtarësisë së tyre në komisionin mbikëqyrës parlamentar. Cilado shkelje e obligimit për ruajtjen e fshehtësisë është e dënueshme siç përcaktohet në nenin 34 të këtij ligji.

38.2 Komisioni mbikëqyrës parlamentar krijon procedurë me shkrim për të mbrojtur zbulimin e jo autorizuar të të gjithë informacionit të klasifikuar që i ofrohet organit mbikëqyrës parlamentar.

KAPITULLI VIII

MEKANIZMAT E ANKESËS

Neni 39

39.1 Individët, institucionet dhe palët e treta kanë të drejtën e ankesës ndaj AKI-së.

39.2 Ankesat mund t'i drejtohen Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës (IOK).

39.3 Cilado ankesë paraqitur IOK-së nuk cenon të drejtën e një individi, institucioni apo pale të tretë të kërkojë shqyrtim nga një gjykatë.

KREU VIII

FINANCIMI

Neni 40

Përgatitja dhe ofrimi i buxhetit

40.1 Drejtori i AKI-së harton dhe paraqet kryeministrit, për aprovim dhe dorëzim tek komisioni mbikëqyrës parlamentar, projekt buxhetin vjetor për AKI-në, detajet e të cilit konsiderohen informacion i klasifikuar.

40.2 Kuvendi i Kosovës i vë në dispozicion AKI-së buxhetin vjetor të mjaftueshëm për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë për të mbrojtur sigurinë e Kosovës.

Neni 41

Përgjegjësia e shpenzimeve

41.1 Drejtori i AKI-se është përgjegjës për shpenzimin e ligjshëm të fondeve të dhëna AKI-së.

41.2 Shumat të cilat i vihen në dispozicion AKI-së shpenzohen nga drejtori i AKI-së apo ata të cilëve drejtori i AKI-së ia ka deleguar këtë përgjegjësi në pajtueshmëri me ligjet e Kosovës, për cilindo qëllim të nevojshëm për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e AKI-së.

Neni 42

Shpenzimet emergjente

42.1 Në rrethana të jashtëzakonshme relevante për punën e AKI-së, drejtori i AKI-së mund të shpenzojë fonde pavarësisht dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me shpenzimet e fondeve qeveritare, përveç nëse përndryshe ndalohet në mënyrë të veçantë me ligj.

42.2 Nëse drejtori i AKI-së ushtron autorizimin të bëjë shpenzime emergjente ashtu siç është paraparë më lart, ai apo ajo i raporton menjëherë gojarisht kryeministrit për shpenzimin dhe e arsyeton me shkrim brenda dyzetetë (48) orësh pas shpenzimit.

KREU IX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 43

Ndarja kalimtare e resurseve

43.1 Përkundër dispozitave të nenit 1.6 dhe Kapitullit VII të këtij Ligji, Qeveria krijon dispozitë speciale për të ofruar objekte dhe resurse financiare përkatëse AKI-së pas formimit të saj deri në kohën kur financimi i AKI-së mund të kryhet sipas procedurave normale.

43.2 Qeveria vë në dispozicion fonde të tilla të nevojshme për emërimin dhe veprimin fillestar të drejtorit të AKI-së dhe zëvendës drejtorit të AKI-së deri sa fondet e tilla të ndahen në mënyrë specifike nga ana e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Neni 44 **Veprimi kalimtar**

44.1 Me miratim paraprak të kryeministrit, drejtori i AKI-së mund të zbatojë ligje dhe rregullore të zbatueshme ndaj institucionet qeveritare të Kosovës në atë masë që zbatimi i ligjit nuk është në mospërputhje me dispozitat e këtij Ligji. Një zbatim i tillë nuk do të bëhet për një periudhë me të gjatë se gjashtë (6) muaj pas themelimit të AKI-së.

44.2 Në pritje të miratimit dhe zbatimit të legjislacionit relevant për mbrojtjen e informative të klasifikuara, drejtori i AKI-së lëshon rregullore që përkohësisht krijon një sistem për klasifikimin e informacionit, masat për mbrojtjen e këtij informacioni, dhe përgjegjësitë e punonjësve për mbrojtjen e këtij informacioni të sigurisë.

44.3 Krijimi i vendeve të lira të punës që dalin nga ky ligj bëhet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas nenit 45.

44.4 Në pritje të miratimit të procedurës për lejen e sigurisë, Punonjësit e AKI-së mund të marrin leje të përkohshme sigurie, valide deri në gjashtë (6) muaj, nën kushtin që këta punonjës të dorëzojnë pyetësin për lejen e sigurisë, përmbajtja e të cilit nuk zbulon bazat e qarta të refuzimit të lejes së sigurisë. Leja e përkohshme e sigurisë mund të ripërtërihet vetëm njëherë, për një periudhë që nuk mund jetë më shumë se gjashtë muaj.

44.5 neni 44.4 i këtij Ligji zbatohet vetëm ndaj individëve të cilët i bashkohen AKI-së para zbatimit të procedurës për lejen e sigurisë.

Neni 45 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-063
21 maj 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI